



Die Senatorin für Kinder und Bildung · Rembertiring 8-12 · 28195 Bremen

Për
të gjithë prindërit dhe kujdestarët ligjor

Auskunft erteilt
Landesjugendamt

Zimmer

Tel.0176 423 63465

E-Mail:
helena.justa@
kinder.bremen.de

Mein Zeichen
(bitte bei Antwort angeben)
30

Bremen, 26.08.2021

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,
të dashur prindër ose kujdestar ligjor,

pushimet verore së shpejti do të përfundojnë dhe të gjithë fëmijët do të vizitojnë sërish qendrat e kujdesit ditor. Këtu dua t'ju informoj se si Senatorja për Fëmijët dhe Edukimin dëshiron t'i mbrojë fëmijët tuaj, sidomos gjatë fazës delikate pas pushimeve, nga infeksioni me korona virus në qendrat e kujdesit ditor. Bremen po vendos masa të reja për këtë qëllim, sipas rekomandimeve të Institutit Robert Koch (RKI) .

Në javët e para pas pushimeve (nga 02.09.2021-23.09.2021) do t'ju ofrohen dy herë në muaj të ashtuquajturat Testet-Lëpirëse për fëmijët tuaj. Në këtë procedurë testimi, fëmijët do të lëprijnë Tamponët-Lëpirëse „Lolli“ për 30 sekonda. Nuk kërkohet testimi nga hunda ose nga fyti. Të gjitha lëpirëset do të vendosen në një tub i cili më pas do të dërgohet në laborator për vlerësim. Testet do të vlerësohen për secilin grup fëmijësh. Kjo është arsyeja se pse ky test quhet Testi i përzier PCR-Lëpirëse. Me mirëkuptimin tuaj këto teste do të zhvillohen direkt në qendrën e kujdesit ditor.

Nëse një fëmijë nga grupi rezulton pozitiv, qendra e kujdesit ditor mer rezultatit në mëngjesin e ditës pasardhëse.

Shembull:

Nëse testi zhvillohet të hënën në qendrën e kujdesit ditor, rezultati i grupit të fëmijëve do të jetë i disponueshëm të martën në mëngjes.

Në rast se rezultati i një grupi fëmijësh është pozitiv, ju do të merrni një tampon tjetër/ „lëpirëse“ për ta marrë në shtëpi.

Rezultat pozitiv i testit për një grup fëmijësh :

Nëse rezultati i testit të përzier PCR-Lëpirëse të grupit të fëmijëve të fëmijës suaj është pozitiv, ju do të informoheni nga qendra e kujdesit ditor. Atëherë fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi dhe është në karantinë shtëpiake. Më pas, në shtëpinë tuaj, ju do të kryeni një tjetër Test-Lëpirëse me fëmijën tuaj. Pastaj deri në orën 10:30, sillni tamponin/ „Lëpirësen“ në qendrën e kujdesit ditor. Një laborator mer atje tamponët dhe i shqyrton më pas për secilin fëmijë. Kështu ju do të dini me siguri nëse fëmija juaj është i infektuar me korona virus apo nëse fëmija juaj është “thjesht” një person kontakti i ngushtë.


Në këte letër ju do të gjeni gjithashtu një diagram, i cili tregon procedurën e sakte.

Ekziston gjithashtu mundësia e marrjes nga godina të testeve të zakonshme për fëmijën/fëmijët tuaj. Testimi i fëmijës vazhdon të mbetet vullnetarisht.

Gjithë të mirat
Përgjegjës

Thomas Jablonski
Shef i departamentit për edukimin në fëmijërinë e hershme, promovimin e fëmijëve dhe zhvillimin profesional të tyre.

Diagrami i procedurës



[Übersetzt ins Albanische]